

LIGJ
Nr . 8826, datë 5.11.2001

PËR
DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 7564 DATË 19.05.1992
“PËR TË DREJTËN E AUTORIT “

Në mbeshtetje të neneve 78,81 pika 1 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputetit,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISE
V E N D O S I :

Në ligjin nr.7564, datë 19.05.1992 “Për të drejtën e autorit” , ndryshuar me ligjet nr. 7923 datë 19.04.1995, nr .8594 datë 6.04.2000 dhe nr 8630 datë 3.07.2000 bëhen këto shtesa:

Neni 1

Ne fund te nenit 50 shtohet neni 50/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/1

Përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

- a) Përdorimi I pronësisë artistike , nga subjekte fizike dhe juridike, pa lejen e autorit, ose pa kontakt me shoqëritë e mbrojtjes së të drejtave të autorëve , shqiptarë dhe të huaj,në respektim të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkuara nga Republika e Shqipërisë.
- b) Moslargimi në afat I detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi I kontratave ose I autorizimeve midis autorëve shqiptarë ose te huaj ose shoqërisë që mbron të drejtat e tyre, me përdoruesit e peonësisë artistike”.

Neni 2

Në fund të nenit 50/1 shtohet neni 50/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/2

Shkeljet e parashikuara në nenin 50/1 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale,quhen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobe nga inspektorët e kontrollit të Policisë Tatimore në përbërje të Drejtorisë së përgjithshme të Tatimeve.Këta inspektorë, përveç vjeljes së gjobave që parashikohen më poshtë,I detyrojnë përdoruesit të bëjnë edhe arkëtimin e te drejtës së autorit sipas këtij ligji.Gjobat janë si vijon:

1. Gjobë 100 000 – 400 000 lekë për përdoruesit e mëdhenj,si radiot dhe televizionet kombëtare,hotelet,prodhuesit(botuesit) e kasetave, vidiokasetave, kompakdisqeve(CD), si dhe përdorues të tjerë të pronësisë artistike në fushat e letërsisë, arteve vizuale e fotografisë artistike.

2. Me gjobë nga 50 000 – 150 000 lekë për përdoruesit e mesëm, si radiot dhe televizionet lokale, diskotekat, pianobaret, restorantet me pistë për vallëzim, pubet, operatorët e internetit, telebingot dhe lojërat e tjera të fatit që zhvillohen me spektakle, sallat me destinacion tjetër, si Pallati I Kongreseve, stadiume ose palate sporti të lojërave me dorë, kur jepen me qera për koncerte.
3. Me gjobë nga 25 000 – 90 000 lekë për përdoruesit e vegjël, si kafenetë, baret, restorantet, tavernat, hotelet, motelet dhe sallat e gjimnastikës aerobike.

Proçedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masës administrative bëhen në përputhje me ligjin Nr.8560, datë 22.12.1999 “Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3

Në fund të nenit 50/2 shtohet neni 50/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/3

Gjobat e vjelura nga përdoruesit e pronësisë artistike në kundërshtim me ligjin kalojnë gjashtëdhjetë për qind në Buxhetin e Shtetit dhe dyzet për qind në llogari të shoqërive të autorëve”.

Neni 4

Në fund të nenit 50/3 shtohet neni 50/4 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/4

Ministri I Financave nxjerr udhëzim për mënyrën e kontrollit të përdoruesve të pronësisë intelektuale nga organet e Policisë Tatimore.”

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3149, datë 16.11.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**